



Lënda: Njoftim

Të nderuar qytetarë,

Komuna e Bogovinës ka vepruar në bazë të të gjitha dispozitave dhe rregullave ligjore për sa i përket shkollës së Novosellës.

Që nga 22 Tetor 2017, kur komuna e Bogovinës u njoftua nga ana e Drejtorit të atëhershëm të shkollës se gjatë orëve të pasditës është djegur shkolla e Novosellës nga shkaqe akoma të panjohura, nga ana e komunës janë marrë hapa konkrete duke u formuar komision për konstatimin e gjendjes. Pas njoftimit të Ministrisë së Arsimit, poashtu u formua edhe komisioni i ministrisë për konstatim të gjendjes.

Pas vizitës në teren me datë **24.10.2017** nga këto dy komisione u konstatua se zjarri në tërësi ka djegur konstruksionin e çatisë dhe më pas është zgjeruar edhe në brendinë e objektit. Konstatimi i përbashkët i të dy komisioneve është se objekti është djegur në tërësi dhe i njeiti nuk i plotëson as kushtet minimale për vazhdimin e procesit edukativo- arsimor.

Pas kësaj u kërkua nga komisioni komunal që të përgatit dhe të dorëzoj në njësinë për investime kapitale-Ministria e Arsimit këto dokumentacione:

1. Fletëpronësi për të dy objektet,
2. Çertifikatë nga plani për gjithë dokumentacionin e objektit të djegur dhe
3. Çertifikatë nga plani për tokën.

Pas pranimit të shkresës zyrtare të Ministrisë së Arsimit nga ana e komunës me datë **31.10.2017**, komisioni komunal për një periudhë të shkurtë kohore përgatiti dokumentacionin e nevojshëm të shkollës dhe e dorëzoi në ministri me datë **17.11.2017** njësisë për investime kapitale.

Komuna e Bogovinës pas kësaj, morri për obligim sistemimin e nxënësve në mектеbin e xhamisë dhe në disa objekte tjera alternative të cilat do t'i paguan me qira deri në zgjedhjen e çështjes së shkollës.

Pas kësaj shkrese u njoftuam se ndërtimi i shkollës së Novosellës është paraparë për ndërtim në buxhetin e vitit 2018.

Sipas informatave që ne kemi nga ana e njësisë për investime kapitale kemi kuptuar se është përpiluar dokumentacioni për hapjen e tenderit dhe i njeiti qëndron në kabinetin e ministrit që nga marsi i këtij viti, mbetemi me shpresë se i njeiti do të hapet për të zgjedhur kryerësin e punëve.

Shfrytëzoj rastin të njoftoj qytetarët e Novosellës dhe mbarë mbanorët e komunës se komuna e Bogovinës ka ndërmarrë hapat e duhura me kohë, ka njoftuar organet kompetente për objektin shkollor dhe është në pritje të njoftimit nga ana e Ministrisë së Arsimit-njësia për investime kapitale për kohën se kur do të fillojë ndërtimi i objektit.

Me respekt,

Komuna e Bogovinës

Kryetar

Albon Xhemali

